



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI

Adresa: Sheshi "4 Heronjte", Tel. 033 421207 Fax. 033 421207, www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

Nr. 1085 prot

Vlorë, 04.11 2015

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ 2015

**PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE VENDORË
TË NDERIT**


Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbështetje të nenit 14, nenit 15 pika 1 gërma a, neni 17 pika 1 të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë": pasi mori në shqyrtim propozimin e konferencës së kryetarëve të grupeve, VKM nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kreu I,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë
2. Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 punonjës të administratës dhe 2 (dy) personalitete të jashtme.
3. Kryetari i Këshillit të Bashkisë në zbatim të këtij vendimi nxjerr urdhër për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë.
4. Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë i ngritur në zbatim të këtij vendimi për vitin 2015 do të ushtrojë kompetencat e tij deri në fund të vitit 2016.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, neni 33, pika 6.

KRYETARE


Vojsava SHKURTAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

RELACION
mbi
PROJEKT-VENDIMIN

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE VENDORË
TË NDERIT

Të nderuar Këshilltarë.

Materiali që po ju paraqesim për diskutim dhe miratim mbështetet në nenin 14, nenin 15 pika 1 gërma a, nenin 17 pika 1 të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë": pasi mori në shqyrtim propozimin e konferencës së kryetarëve të grupeve, VKM nr.861, datë 10.12.2014 " Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kreu I.

Ligji më sipër në Kreun III "Procedura e dhënies së dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit", neni 17, pika 1 përcakton:

1. Çdo autoritet përgjegjës për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit krijon pranë tij një komision këshillimor, të përbërë prej 5 anëtarësh, ku 3 anëtarë duhet të jenë punonjës nën varësinë e tij dhe 2 anëtarët e tjerë personalitete të jashtme.
3. Të gjitha propozimet për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit i dërgohen autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell menjëherë për vlerësim në komisionin këshillimor.

Neni 18, i po këtij ligji përcakton: **Propozimi për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit** - Propozimi duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur.

Veprimtaria e Komisionit Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Bashkinë Vlorë bazohet në VKM nr.861, datë 10.12.2014 " Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë".

KRYETARE


Vojsava SHKURTAJ

